



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 76

Prishtinë, më 20.7.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Elheme Hetemi, Zef Morina, Berat Luzha, Myrvete Pantina, Heset Cakolli, Selvie Halimi.

Mungoi : Branislav Grbić, Ali Lajçi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 6.7.2010,
3. Projektligji për VSM dhe për ujëra ,
4. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për çka komisioni nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 6.7.2010

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Caktimi i grupeve punuese për projektligjin për VSM dhe për Ujëra

Naser Rugova hapi shqyrtimin rreth këtyre dy projektligjeve të miratuara në leximin e parë dhe pas konsultimeve u caktuan grupet punuese si vijon :

Heset Cakolli-kryesues, Selvie Halimi, Qazim Kukalaj si grup punues do të shqyrtojnë projektligjin për Vlerësimin strategjik mjedisor.

Zef Morina-kryesues, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi dhe Qazim Kukalaj si grup punues do të shqyrtojnë projektligjin për ujërat.

4. Të ndryshme

Naser Rugova theksoi lëvdatën që i është bërë punës së këtij komisioni në mbledhjen e kryesisë, ndaj për të vazhduar këtë temp të punës së komisionit sugjeroi disa aktivitete për muajin shtator-tetor kur pritet të vazhdoi punën Kuvendi pas pushimeve verore. Ai propozoi mbajtjen e një debati dy ditor jashtë Prishtinës në fund të shtatorit ose në fillim të tetorit lidhur me Bujqësi (prodhuesit vendor) dhe politikat Mjedisore.

Naim Maloku tha se projektligji i kthyer në Qeveri për Mbrojtjen e Natyrës është rikthyer prapë në Kuvend dhe sugjeroi që pas leximit të parë menjëherë të vazhdoi punën grupi punues i caktuar lidhur me amendamentim, njëkohësisht njoftoi komisionin me disa çështje aktuale nga mbledhja e kryesisë, me çka konstatoi se ky komision nuk cakton më mbledhje në sesionin pranveror.

Berat Luzha propozoi debat publik lidhur me projektligjin për ujërat.

Naser Rugova u pajtua me dy parafolësit ngase me ditën e sotme ky komision përfundon sesionin pranveror, ndërkaq debati publik për ujëra do të mbahet pas debatit dyditor për bujqësi dhe mjedis (**Zef Morina** u pajtua por sugjeroi që grupi punues të filloi punën pastaj të propozohet ndonjë debat eventual).

Elheme Hetemi e ngriti çështjen e përfaqësimit ndërkombëtar nëpër debate të ndryshme kur ftohet ky komision dhe propozoi që komisioni të jetë më i përgjegjshëm, përkatësisht të përgjigjet ftesave ku përfaqësohet niveli rajonal-ndërkombëtar.

Naser Rugova theksoi se ftesat duhet të janë në afat të dërguara dhe të njoftohet komisioni me kohë nga përfaqësues ndërkombëtar ose OJQ që organizojnë takime me elemente ndërkombëtare, ngase aktivitetet e dendura nuk lejojnë që të kemi akomodim në zgjedhjen e takimeve ku do të shkohet.

Kryetari **Naser Rugova** përshëndeti anëtarët e komisionit deri në shtator dhe ju uroi pushimet e mira.

Komisioni pas mbledhjes kishte një takim pune-drekë pune me ministrin Blerand Stavilecin.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 13,30.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova